

Kush nuk e dëgjon këngën në shqip, do ta dëgjojë stuhinë, apo si ishte e mundur të luftohej kundër nacionalizmit me muzikën jugosllave

Vitet tetëdhjetë të shekullit 20 sot paraqiten si një periudhë kohore që është intriguese për shumë arsye. Së pari, ajo nuk është mjaftueshëm e largët historikisht që të mos kemi një kujtim emocional të saj, madje edhe nëse ato janë kujtime që i trashëgojmë prej të tjerëve. Më pas, e dimë se fillimi i viteve tetëdhjetë, simbolikisht i shënuar me vdekjen e Josip Broz Titos, shënoi edhe nisjen e zhvillimeve të përshpejtuara turbulente në këto hapësira, dhe se kjo deçenie ishte hyrje në të nëntëdhjetat kaotike. Është krejt e qartë se kjo ishte kohë e problemeve të mëdha ekonomike, mungesave, dezintegritimit evident të idealeve të cilët, deri diku, mbaheshin për aq sa i promovonte figura e gjallë e udhëheqësit të të gjitha kombeve dhe kombësive. Tutje, këtë deçenie e shënuan forcimi i nacionalizmit, ashpërsimi i krizës në Kosovë, dhe vëmendja gjithnjë e më e madhe mediale e drejtuar nga largimi i serbëve nga ky territor, që në mediat serbe paraqitej si rezultat i krimeve të shqiptarëve. Megjithatë, çfarëdo që ishin vitet tetëdhjetë të shekullit 20, sot ato janë subjekt, duket, i një nostalgjie paksa të pashpjegueshme – të pashpjegueshme për shkak se mund të pyesim se për çka saktë ka mall në ato komente nostalgjike për një kohë që ishte larg nga të qenit idilike siç e paraqesin në momente jugonostalgjikët.

Dua, së pari, të arsyetoj pse e kam konsideruar të rëndësishme të shkruaj për muzikën jugosllave dhe nacionalizmin. Kohët e fundit jam marrë me hulumtimin e tri temave: së pari, marrëdhëniet serbo-shqiptare në diskurset shkencore të shekujve 19 dhe 20, pranimit të muzikës jugosllave në kohën pasjugosllave, (e posaçërisht të muzikës kroate në Serbinë e sotme) dhe, në fund, me muzikën jugosllave pikërisht në deçenien intriguese, të fundit në ekzistimin e shtetit të dikurshëm. Të gjitha temat e përmendura më janë lidhur (duket papritmas, por gjithsesi jo edhe rastësisht) kur në literaturë gjeta shënimin se grupi Bijelo Dugme në vitin 1983 ka incizuar një këngë në gjuhën shqipe. Këtë shënim, në fakt, disi e kam ditur edhe vetë, nga kujtesa e mjegulluar fëmijërore e viteve tetëdhjetë. Kur e lexova këtë, dhe e dëgjova këngën, vetë informata nuk më është dukur e panjohur, por për herë të parë më është shfaqur krejt qartë rëndësia e saj, nga perspektiva e sotme e shkencëtares. Para së gjithash, isha e habitur me vetë faktin se kjo informatë më shokoi aq shumë. Pse më dukej aq e pabesueshme të besoj se një grup jugosllav kishte kënduar në gjuhën shqipe? Duke u marrë në mënyra të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme me problemet e

* Ana Petrov është muzikologe dhe sociologe, docente në Fakultetin për media dhe komunikim në Beograd. Doktoratën nga sociologjia e muzikës e ka mbrojtur në Fakultetin Filozofik në Beograd. Ka botuar librat "Bruno Latur" (Beograd, 2015), "Pjer Burdije" (Beograd, 2016), "Rethinking Rationalisation. Evolutionism and Imperialism in Max Weber's discourse on Music" (Wien, 2016), "Muzika jugosllave pa Jugosllavi. Koncertet si vend i kujtimit" (Beograd, 2016), si dhe një numër artikujsh në revistat vendore dhe ndërkombëtare shkencore.

krijimit dhe tejkalimit të kufijve me ndihmën e muzikës, e kam kuptuar se decenia e shqyrtuar ishte një periudhë e produksionit të madh të këngëve që paraqisnin lutje, apele dhe paralajmërime se çka mund të na ndodhë. Andaj, këtu merrem me këngën e lartpërmendur si një tentim i llojit të vet të mbizotërimit ndaj nacionalizmit në rritje në Jugosllavi. Tutje, këtë këngë e interpretoj si një shfaqje simptomatike në kornizën e tendencës së përmendur që përmes muzikës të apelohej rreth problemeve që krijoheshin në shoqërinë jugosllave. Këtu, dua të tërheq vëmendjen në disa mendime që mua më janë kristalizuar me rastin e gjithë kësaj që u përmend. Pse sot nuk mund të këndohet në gjuhën shqipe? A janë ndjenjat e sotme nostalgjike për vitet tetëdhjetë të shkaktuara pikërisht nga muzika? A ishin vitet tetëdhjetë të veçanta vetëm për shkak se atëherë krijohej muzika që ishte aq shumë e popullarizuar/e mirë/provokative, apo madje, edhe politikisht e angazhuar në shoqëri, sido që ta etiketojmë, saqë besohej se ajo vetë mund të ndryshonte diç?

Tendencat në politikën e muzikës së popullarizuar jugosllave gjatë decenies së fundit të shtetit jugosllav mund të sistematizohen në tri rryma paralele. Së pari, mund të lokalizohet përpjekja për promovimin e “muzikës së të rinjve”, e cila, varësisht nga momenti dhe vendndodhja konkrete, mund të ishte rok apo pank apo diç tjetër. Më pas, njëkohësisht shfaqeshin këngët e paralajmërimeve, sikur edhe lutjet. Së fundi, nga fundi i viteve tetëdhjetë, situata ishte e qartë dhe e papërmirësueshme. Mund të këndohej vetëm edhe rekuemi.

Rokenrolli do të na mbajë?

“Rokenrolli do të na mbajë”, thanë reporterët që transmetonin ceremoninë me rastin e Ditës së Rinisë në vitin 1984. Ky moment është njëri prej kryesorëve në shqyrtimin e rolit të muzikës në luftë kundër nacionalizmit të viteve tetëdhjetë të shekullit 20 në Jugosllavi. Pra, muzika publikisht është etiketuar si mjet i mundshëm i shpëtimit dhe revitalizimit të idealit të vëllazërim-bashkimit. Edhe pse muzika e popullarizuar përdorej edhe më herët në këto festime, dhe po ashtu kishte edhe rol në promovimin e politikës kulturore shtetërore gati gjithë kohën sa ka ekzistuar RSFJ, ky vit veçohet për mënyrën e promovimit të muzikës së popullarizuar si muzikë e së ardhmes. Po ashtu, funksioni i muzikës së popullarizuar është ndryshuar. Për dallim nga këngët e deriatëhershme të komponuara me përmbajtje pasqyruese për Jugosllavinë dhe udhëheqësin e saj, në vitet tetëdhjetë fokusi zhvendoset në promovimin e muzikës së popullarizuar në formën e saj origjinale – pra, nuk ishte e domosdoshme që përmbajtësisht të flitet për vendin, por mundej që, për shembull, të luhej edhe muzika për vallëzim e cila përdorej jashtë kontekstit të vetë manifestimeve. Deri në vitet tetëdhjetë, e posaçërisht në manifestimet që janë mbajtur në vitet pesëdhjetë, me rëndësi ishte tradita e luftës nacional-çlirimtare, andaj dhe luheshin këngë në të cilat vendosej tradita e kujtimit të së kaluarës. Muzika shqiptare, para së gjithash folklori nga Kosova, ishin pothuajse rregullisht pjesë e qasjes së tillë “folklorike” të organizimit muzikor të manifestimit. Pra, të gjitha kombet dhe kombësitë, të gjitha republikat dhe krahinat, ishin të përfaqësuar, jo me muzikën e tyre të popullarizuar, por me muzikën që konsiderohej tradicionale. Me kombinimin e tyre muzikor e vizual dhe me bashkimin e tyre krijohej edhe lidhshmëria simbolike në terren.

Për dallim prej kësaj, vitet tetëdhjetë e sjellin një shikim drejt së ardhmes përmes muzikës së popullarizuar. Në masë gjithnjë e më të vogël luhen këngët me të cilat



Foto: Kurir

Rok-grupi i popullarizuar jugosllav "Bjelo dugme"

lartësohet kujtimi për luftën dhe heroizmat e Titos në të, ndërsa vërehet edhe përdorimi i reduktuar i folklorit, sepse konsiderohej si metodë e tejkaluar e cila nuk është më atraktive për shoqërinë. Në përpjekje për të tejkaluar ndryshimin në vend dhe për të zbutur krizën, organizatorët kishin nisur projektin e modernizimit të manifestimit. Përveç arritjes së një tingulli më modern me përdorimin e instrumenteve bashkëkohore, siç ishte sintisajzeri, veçanërisht punohej në promovimin e asaj që qartë u tregua si një prej lidhëseve më të forta të jugosllavëve dhe jugosllaveve – muzika e popullarizuar jugosllave. Për të nisi të flitej si për “të ardhmen tonë” të vetme, meqë ajo njihej si muzika e rinisë, andaj, dhe, tek ajo shihej potenciali që “të na mbajë bashkë”, përkatësisht që sërish të lidhë kolektivitetin e shprishur jugosllav. Ajo që duket posaçërisht indikative është përpjekja që muzika të paraqitet si një prej zgjidhjeve të mundshme të krizës dhe si mjet për parandalimin e fundit tragjik, së paku në nivelin simbolik, sikur edhe në nivelin e rregullimit të jetës së përditshme. Marrë parasysh që muzika jugosllave ishte një prej projekteve serioze ekonomike dhe mediale të Jugosllavisë socialiste, dhe se në vitet tetëdhjetë padyshim u bë një prej produkteve më reprezentative kulturore të saj, si në kornizat e vendit ashtu edhe jashtë, nuk është befasuese politika e promovimit pikërisht të kësaj muzike si mënyrë për zgjidhjen e konflikteve. Siç u tha në transmetimin e manifestimit të përmendur të Ditës së Rinisë të vitit 1984, “roku është ajo që na bashkon në jetën e përditshme”.

Gjithçka mund të jetë rock'n'roll

Rreth asaj se në cilën masë është besuar në ndikimin e muzikës së popullarizuar dëshmojnë disa këngë simptomatike që janë incizuar gjatë viteve tetëdhjetë. Këtu do të ndalem te kënga Kosovska (E Kosovës). E krijuar në vitin 1983, pra, pas protestave

të shqiptarëve të vitit 1981, në Kosovë, e më pas të serbëve të vitit 1982, përkatësisht në momentin kur çështja e statusit të kësaj krahine të atëhershme jugosllave në masë të madhe ishte aktuale dhe para së gjithash problematike. Por, kjo këngë, për dallim nga shumë këngë tjera të krijuara në atë kohë dhe me atë qëllim (qëllimi për thirrje për paqe), nuk është as lutje, as thirrje për veprim, por një këngë e thjeshtë e dashurisë. Tutje, as të gjithë albumin ku bën pjesë ajo (Uspavanka za Radmilu M. – Ninuilla për Radmilla N.) nuk e ka përcjellë pompa mediale që rëndom lidhej me Bijelo Dugme. As nuk pati tekste problematike, as fotografi që konsideroheshin të papërshtatshme për ballinën e albumit, siç ishte shpeshherë rasti me këtë grup. Ky ishte një album i rëndomtë, me vetëm një këngë të pazakonshme dhe historikisht të rëndësishme, tekstin i së cilës (autorët: Goran Bregoviq, Agron Berisha, Zija Berisha dhe Shpend Ahmeti) është:

*Sonte te lutem behu gadi
Se do te vije vone pas teje
Hape moj dollapin, zgjedhe ti,
Fustanin me te mire.*

*Regulloi floket, bukuri
Ashtu moj ti vete si di
Ne bystek ven lul bozhure
Dua te jeshe nder te gjitha me e mire.*

*A e din se t'gjithe do te jene atje
Per ne te dy do te kete hare
Shkojme se bashku, nje dy tre
Roka mandolinen bjeri bjeri bjeri ciftelies
Te gjithe doo t'kendojme
Kenga le t'jehoje*

Cdo gje mund te jete Roken-roll!

*Nese nena nuk t'lejon
A tehere gjeje shteg vete si di
Mos u ngut, mos u shpejto
Prit gjersa gjumi e kaplo.*

*Pervjedhu nga kapigjiku
Ruj fustanin mos e gris
Ke kujdes mos e humb bozhurin
Dua te jeshe hej moj si hyjneshe.*

Sipas disa dëshmime, Zheljko Bebek kujtohet se në grup kishte frikë që serbët mund të mos ta donin më Bijelo Dugmen për shkak të këngës në gjuhën shqipe. Kjo këngë edhe atëherë e edhe sot, gjithsesi se mund të interpretohet në disa nivele. Në fillim të viteve tetëdhjetë, pas ngjarjeve në Kosovë, të këndosh këngë në gjuhën shqipe ka mundur të jetë provokim politik. Njëkohësisht, ka mundur të shënojë një ofertë muzikore për paqe. Edhe pse ndoshta atëherë veç ishte vonë që situata në Kosovë të ndryshohet, siç e thotë Dushan Vesiqi, ka mbetur e shënuar ajo përpjekje don kishoteske e Bijelo Dugmes.

Edhe pse gjithmonë problematik dhe provokativ, Bijelo Dugme deri atëherë nuk ka qenë edhe grup i angazhuar politikisht, e madje edhe kur gjatë viteve tetëdhjetë do të bëhet i tillë, anëtarët e këtij grupi gjenin mënyra që porositë e tyre të mos i promovojnë në mënyrë krejt eksplicite. Kështu Goran Bregoviçi e komentonte këngën në gjuhën shqipe gati duke e injoruar faktin se bëhet fjalë për një këngë politikisht problematike. Për shembull, janë shënuar deklaratat e tij për atë se “pas gjithë atyre viteve sa jetojmë me shqiptarët nuk do të ishte keq që të mësojmë së paku disa fjalë të tyre”, ndërsa po ashtu e theksonte se gati se nuk e kishte planifikuar që kënga të jetë në gjuhën shqipe, por ajo i kishte “tingëlluar shqip” pasi që e kishte komponuar. Nga aspekti muzikor, ky album i Bijelo Dugmes shënoi edhe ndryshim në zhanër – gjatë viteve tetëdhjetë ky grup do të braktisë statusin e përfaqësuesit tipik të rokut të barinjve dhe do të niset në drejtim të valës së re muzikore. Ky album ka sjellë disa këngë që mes vete kanë shumë dallime, kështu që Kosovska mes tyre e ndante fatin e gjithë albumit, i cili ka kaluar jo aq i vërejtur sa ishte mësuar grupi me albumet e veta në decenien paraprake.

Jugosllavi, çohu në këmbë, këndo, le të dëgjojnë

Por, angazhimin e vet latent politik grupi do ta vazhdojë edhe më vonë, ndërsa po ashtu janë shënuar edhe refleksionet për këngën në gjuhën shqipe nga perspektiva e të tetëdhjetave të vonshme. Qartë, kjo ishte koha kur vetëm dy-tre vjet dallim mund të kishin domethënien e një ndryshimi të madh në pranimin e një situatë të caktuar politike. Kështu, të tetëdhjetat kanë shënuar deklaratat e Bregoviçit për jugosllavizmin, propagues i hapur i të cilit ai ishte, si dhe vendin e shqiptarëve në kornizën e kësaj. Gjatë kësaj decenie problematike, në intervista këtij muzikanti i shtrohej pyetja se sa është i dëshiruar jugosllavizmi, përkatësisht, nëse, madje, mund të paraqesë edhe rrezik. Dhe në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjetë, Bregoviçi në mënyrë eksplicite përgjigjej se ideja e jugosllavizmit është jashtëzakonisht e nevojshme, jo rrallë duke përmendur pikërisht çështjen shqiptare si një shumë të rëndësishme. Në librin *Bolja prošlost* (E kaluara më e mirë), Petar Lukoviçi ka shënuar këtë përgjigje të Bregoviçit në lidhje me angazhimin e tij në favor të jugosllavizmit:

Ideja e jugosllavizmit jo vetëm që është e nevojshme, por është e domosdoshme. Ku do të shkojmë me ata fëmijë që më nuk janë kroatë, as serbë, as sllovenë, e as shqiptarë?[...] Ndarja në bazë të nacionalitetit është primitive, këto janë ide nga koha e feudalizmit, mesjeta. Është e mundur që ky angazhimi për jugosllavizmin të më kushtoj, sepse unë eci tutje duke llogaritur të jem i popullarizuar.

Tutje, Bregoviçi e përmend edhe situatën në Kosovë, duke konetuar se për këtë gjë njeriu duhet të ndihet “tmerrësisht i pikëlluar”. Në kuadër të propagimit të jugosllavizmit, ky muzikant pa mëdyshje qartë theksonte rëndësinë e inkorporimit të shqiptarëve në shoqërinë jugosllave, marrë parasysh atë se ka përmendur se si e

njuh atë publik, dhe se si ata janë “si çdo popull tjetër”, dhe se nuk janë as ma të mirë e as ma të këqij sesa serbët e mirë dhe të këqij apo kroatët e mirë e të këqij“. Por, një ndryshim dallohet në diskursin e Bregoviqit. Për dallim nga loja demagogjike në deklaratat në lidhje me këngën Kosovska, në kohën kur ajo është krijuar, disa vite më vonë, ky muzikant në mënyrë eksplicite theksoi se ka qenë “shumë i gëzuar” kur e ka krijuar atë këngë në gjuhën shqipe, sepse “në atë moment ka menduar se është koha që të mësojmë tri fjalë në shqip, ndoshta kur të këndojmë së bashku do të mund të gjendemi diku”. Pas pyetjes nëse kjo dëshirë i është jetësuar, Bregoviqi e pranon se bëhej fjalë për një paramendim utopik në të cilin ka besuar, por që nuk i është realizuar.

Muzika e Bijelo Dugmes po ashtu e ka braktisur idealin e këndimit të këngës politikisht të angazhuar, por njëkohësisht edhe të thjeshtë të dashurisë. Për dallim nga Kosovska, në albumin Pljuni i zapjevaj, moja Jugoslavijo (Pështyjë dhe këndo, Jugosllavia ime) nga viti 1986, kënga me të njëjtin emër më nuk e sjell paralajmërimin subtil përmes një diskursi të dashurisë, e as lutjen për zgjidhjen e problemeve, por me një tonalitet prej himni i drejtohet, siç thuhet në këngë, “me britmë” vendit të vet dhe e porositë se kush nuk e dëgjon këngën do ta dëgjojë stuhinë.

Pa marrë parasysh të gjitha interpretimet e mundshme ndaj të cilave mund ta nënshtrijmë projektin e angazhimit të muzikës së popullarizuar jugosllave në kontekstin e çështjeve nacionaliste të viteve tetëdhjetë, është gati e sigurt se Kosovska ka mbetur një përpjekje unikale që kultura shqiptare të integrohet në atë jugosllave. Këtë vërtet askush, as para, as pas saj, nuk e ka bërë (edhe pse kjo këngë nuk është përpjekja e vetmuar në mbisundimin përballë nacionalizmit në Jugosllavi, e as nuk është e vetmja këngë provokative politike në opusin e këtij grupi). Ndërsa sot, në të ashtuquajturën kohë dhe hapësirë post-jugosllave, ose siç quhet në gjuhën e popullarizuar “rajon”, një gjë e tillë askujt nuk do t’i binte ndërmend, e duket se as që do të kishte aq rëndësi. Në historinë e muzikës, rrallë mund të shënohet një kapacitet i tillë emotiv dhe politik i muzikës, sikur edhe i bindjes utopike se me muzikë mund të përmirësohet një situatë e ndërlikuar politike, çfarë e kishte muzika e popullarizuar jugosllave e viteve tetëdhjetë të shekullit 20. Grupi i cili gati prej vetë zanafillës së saj konsiderohej si një fenomen tipik kulturor jugosllav, ndërsa sot quhet simbol i asaj kohe, ka mundur të bëjë gjithçka, siç e thotë Vesiqi, pra edhe të këndojë në shqip. Andaj, që t’i kthehem pyetjes nga fillimi i shkrimit: edhe pse të tetëdhjetat ishin kohë krize, ato janë shënuar edhe nga një fenomen specifik historik – ideali se muzika mund të ndryshojë botën, ose, së paku, të tërheqë vërejtjen për problemet që ka bota. Ndoshta pikërisht në këtë edhe mund të gjenden disa prej arsyeve për nostalgjinë në shikim të parë të pashpjegueshme për vitet tetëdhjetë.

Ana Petrov është muzikologe dhe sociologe, docente në Fakultetin për media dhe komunikim në Beograd. Doktoratën nga sociologjia e muzikës e ka mbrojtur në Fakultetin Filozofik në Beograd. Ka botuar librat “Bruno Latur” (Beograd, 2015), “Pjer Burdije” (Beograd, 2016), “Rethinking Rationalisation. Evolutionism and Imperialism in Max Weber’s discourse on Music” (Wien, 2016), “Muzika jugosllave pa Jugosllavi. Koncertet si vend i kujtimit” (Beograd, 2016), si dhe një numër artikujsh në revistat vendore dhe ndërkombëtare shkencore